

tia



Ndjenja
eshte
Sekreti

Perktheu Ledion Azemaj

NEVILLE

NDJENJA ËSHTË SEKRETI

nga Neville Goddard

Ky botim elektronik u publikua në Shqip në vitin 2023 nga Ionweb

Përktheu **Ledion Azemaj**

ionweb

PARATHËNIE

Ky libër ka të bëjë me artin e realizimit të dëshirës tënde. Ai të jep një përshkrim të mekanizmit të përdorur në prodhimin e botës së dukshme. Është një libër i vogël, por jo i dobët. Ka një thesar në të, një rrugë e përcaktuar qartë drejt realizimit të ëndrrave të tua.

Nëse do të ishte e mundur t'i jepej bindja një tjetri me anë të argumenteve të arsyetuara dhe shëmbujve të detajuar, ky libër do të ishte shumëfishi i madhësisë së tij. Megjithatë, rrallë është e mundur të bëhet një gjë e tillë me anë të deklaratave ose argumenteve të shkruara, pasi për gjykimin e pezulluar gjithmonë duket e besueshme të thuhet se autori ishte i pandershëm ose i mashtruar dhe, si për rrjedhojë, provat e tij ishin të ndotura.

Rrjedhimisht, unë i kam hequr qëllimisht të gjitha argumentet dhe dëshmitë dhe thjesht sfidoj lexuesin mëndjehapur që të praktikojë ligjin e vetëdijes siç zbulohet në këtë libër.

Suksesi personal do të jetë shumë më bindës se të gjithë librat që mund të shkruhen për këtë temë.

–NEVILLE GODDARD

Kapitulli 1

Ligji dhe funksionimi i saj

Bota, dhe gjithçka brënda saj, është vetëdija e njeriut objektivisht e kushtëzuar. Vetëdija është shkaku dhe substanca e gjithë botës. Pra, ne duhet t'i drejtohem vetëdijes nëse do të donim të zbulonim sekretin e krijimit. Njohja e ligjit të vetëdijes dhe mënyra e funksionimit të këtij ligji do të të mundësojë ty të përmbushësh gjithçka që ti dëshiron në jetë. Të armatosur me një njohuri pune të këtij ligji, ti mund të ndërtoosh dhe mbash një botë ideale. Vetëdija është realiteti i vetëm, jo figurativ por real. Ky realitet, për hir të qartësisë, mund të krahasohet me një rrymë që ndahet në dy pjesë, Koshient dhe Subkoshient. Për të zbatuar në mënyrë inteligjente ligjin e vetëdijes, është e nevojshme të kuptohet marrëdhënia midis Koshiencës dhe Subkoshiencës. Koshienca është personale dhe selektive; Subkoshienca është jopersonale dhe jo selektive. Koshienca është sfera e efektit; Subkoshienca është sfera e shkakut. Këto dy aspekte janë ndarja e vetëdijes mashkullore dhe femërore. Koshienca është mashkullore; subkoshienca është femërore.

Koshienca gjeneron ide dhe i impresionon këto ide në subkoshiencë; subkoshienca i merr ato ide dhe u jep atyre formë dhe shprehje. Me anë të këtij ligji – fillimisht konceptimi i një ideje dhe më pas impresionimi i idesë së konceptuar në subkoshiencë – të gjitha gjërat evoluojnë jashtë koshiencës; dhe, pa këtë sekuencë, nuk bëhet asgjë që mund të bëhet. Koshienca i impresionon subkoshiencës, ndërsa subkoshienca shpreh gjithçka që ngulitet në të. Subkoshienca nuk lind ide, por pranon si të vërteta ato që mëndja koshiente i ndjen si të vërteta dhe, në një mënyrë të njohur vetëm për veten, i objektivizon idetë e pranuar. Prandaj, përmes fuqisë për të imagjinuar dhe ndjerë dhe lirinë për të zgjedhur idenë që do të argëtojë, njeriu ka kontroll mbi krijimin. Kontrolli i subkoshiencës arrihet përmes kontrollit të ideve dhe ndjenjave të tua.

Mekanizmi i krijimit fshihet në thellësinë e subkoshiencës, aspektin femëror ose ndryshe barku i krijimit.

Subkoshienca tejkalon arsyen dhe është e pavarur nga induksioni. Ajo soditon një ndjenjë si një fakt që ekziston brënda vetes dhe mbi këtë supozim ajo vazhdon ta shprehë atë. Procesi krijues fillon me një ide dhe cikli i saj ecën si një ndjenjë dhe përfundon në një vullnet për të vepruar. Idetë impresionohen në subkoshiencë përmes mediumit të ndjenjës.

Asnjë ide nuk mund të ngulitet në subkoshiencë derisa ajo të ndihet, por sapo ajo të ndihet – qoftë e mirë, e keqe apo indiferente – ajo duhet të shprehet. Ndjenja është mjeti i vetëm përmes së cilës idetë përcillen në subkoshiencë. Prandaj, njeriu që nuk e kontrollon ndjenjën e tij, lehtë mund të lërë përshtypje subkoshiente me gjëndje të padëshirueshme. Me kontroll të ndjenjës nuk nënkuptohet kufizimi ose shtypja e ndjenjës sënde, por më tepër disiplinimi i vetes për të imagjinuar dhe argëtuar vetëm një ndjenjë të tillë që kontribuon në lumturinë tënde. Kontrolli i ndjenjave të tua është gjithçka e rëndësishëm për një jetë të plotë dhe të lumtur.

Asnjëherë mos ushqe një ndjenjë të padëshirueshme, as mos mendo me simpati për gabimet në çfarëdo lloj formë. Mos u ndal në papërsosmërinë e vetes ose së të tjerëve. Të bësh këtë do të thotë t'i bësh përshtypje subkoshiencës me këto kufizime. Ajo që ti nuk dëshiron që ty të të bëhet, mos mendo se të është bërë ty apo dikujt tjetër. Ky është i gjithë ligji i një jete të plotë dhe të lumtur. Gjithçka tjetër është koment.

Çdo ndjenjë bën një përshtypje në subkoshiencë dhe, nëse nuk kundërshtohet nga një ndjenjë më e fuqishme e një natyre të kundërt, ajo duhet të shprehet. Dominuesja e dy ndjenjave është ajo e shprehur. Unë jam e shëndetshme është një ndjenjë më e fuqishme se sa Unë do të jem e shëndetshme. Të ndiesh se unë do të jem do të thotë të rrëfesh se unë nuk jam; Unë jam është më e fuqishme se unë nuk jam. Ajo që ti ndien se je dominon gjithmonë atë që ti ndien se do të doje të ishe; prandaj, për t'u realizuar, dëshira duhet të ndihet si një gjëndje që tashmë është më shumë sesa një gjëndje që nuk është.

Ndjesia i paraprin manifestimit dhe është themeli mbi të cilën mbështetet i gjithë manifestimi. Ki kujdes nga disponimi dhe ndjenjat e tua, sepse ekziston një lidhje e pandërprerë midis ndjenjave të tua dhe botës sënde të dukshme. Trupi yt është një filtër emocional dhe mban shenjat e pagabueshme të emocioneve të tua mbizotëruese. Çrregullimet emocionale, veçanërisht emocionet e ndrydhura, janë shkaktarët e të gjitha sëmundjeve.

Të ndihesh intensiv për një gabim pa e folur apo shprehur atë ndjenjë është fillimi i sëmundjes - sëmundjes - si në trup ashtu edhe në mjedis. Mos e ushqe ndjenjën e keqardhjes ose dështimit për zhgënjimin ose shkëputjen nga rezultatet e tua objektive në sëmundje.

Mendo me ndjenja vetëm për gjëndjen që ti dëshiron të realizosh. Të ndjesh realitetin e gjëndjes së kërkuar dhe të jetosh e të veprosh sipas asaj bindje është rruga e të gjitha mrekullive në dukje. Të gjitha ndryshimet e shprehjes ndodhin përmes një ndryshimi të ndjenjës.

Ndryshimi i ndjenjës është një ndryshim i fatit. I gjithë krijimi ndodh në fushën e subkoshiencës. Ajo që ti duhet të fitosh, pra, është një kontroll reflektues i funksionimit të subkoshiencës, domethënë kontrolli i ideve dhe ndjenjave të tua. Rasti apo aksidenti nuk është përgjegjës për gjërat që ty të ndodhin, as fati i paracaktuar nuk është autori i fatit apo fatkeqësisë tënde. Përshtypjet e tua subkoshiente përcaktojnë kushtet e botës tënde.

“Subkoshienca nuk është selektive; është jopersonale dhe nuk respekton persona.”

-Veprat 10:34; Romakët 2:11

Subkoshienca nuk shqetësohet për të vërtetën ose falsitetin e ndjenjës tënde. Ajo gjithmonë e pranon si të vërtetë atë që ti e ndjen të jetë e vërtetë. Ndjenja është pëlqimi i subkoshiencës për të vërtetën e asaj që deklarohet të jetë e vërtetë. Për shkak të kësaj cilësie të subkoshiencës nuk ka asgjë të pamundur për njeriun.

Çfarëdo që mendja e njeriut të mund ta konceptojë dhe ta ndjejë si të vërtetë, subkoshienca mund dhe duhet ta objektivizojë atë. Ndjenjat e tua krijojnë modelin nga e cila bota jote është krijuar, dhe një ndryshim i ndjenjës është një ndryshim modeli.

Subkoshienca nuk dështon kurrë të shprehë atë që asaj i është ngulitur. Në momentin që ajo merr përshtypje, ajo fillon të përpunojë mënyrat e shprehjes së saj. Ajo e pranon ndjenjën e impresionuar në të, ndjenjën tënde, si një fakt që ekziston në brëndësi të vetes tënde dhe menjëherë fillon të prodhojë në botën e jashtme ose objektive ngjashmërinë e saktë të asaj ndjenje.

Subkoshienca nuk i ndryshon kurrë bindjet e pranuar të njeriut. Ajo i nxjerr ato deri në detaje nëse janë të dobishme ose jo.

Për ti bërë përshtypje subkoshiencës me gjëndjen e dëshirueshme, ti duhet të pohosh ndjenjën që do të ishte e jotja nëse do ta kishe realizuar tashmë dëshirën tënde. Në përcaktimin e objektivit tënd, ti duhet të shqetësohesh vetëm për vetë objektivin. Mënyra e të shprehurit ose vështirësitë e përfshira nuk duhet të merren parasysh nga ty.

Të mendosh me ndjenjë për çdo gjëndje, e impresionon atë në subkoshiencë. Prandaj, nëse ndalesh te vështirësitë, pengesat ose vonesat, subkoshienca, nga natyra e saj jo shumë selektive, e pranon ndjenjën e vështirësive dhe pengesave si kërkesën tënde dhe vazhdon t'i prodhojë ato në botën tënde të jashtme.

Subkoshienca është barku i krijimit. Ajo e merr idenë në vetvete përmes ndjenjave të njeriut. Ajo nuk e ndryshon kurrë idenë e marrë, por gjithmonë i jep formë asaj. Prandaj subkoshienca e nxjerr idenë në imazhin dhe ngjashmërinë e ndjenjës së marrë. Të ndjesh një gjëndje si të pashpresë ose të pamundur është të impresionosh subkoshiencën me idenë e dështimit.

Edhe pse subkoshienca i shërben me besnikëri njeriut, nuk duhet të konkludohet se lidhja është ajo midis një shërbëtori dhe një zotërie, siç konceptohej në lashtësi.

Profetët e lashtë e quanin atë skllav dhe shërbëtor të njeriut. Shën Pali e personifikoi atë si një "grua" dhe tha: "Gruaja duhet t'i nënshtrohet burrit në çdo gjë" -**Efesianëvt 5:24**; dhe poashtu **1 Korintasit 14:34**, **Efesianët 5:22**, **Kolosianët 3:18**, **1 Pjetri 3:1**.

Subkoshienca i shërben njeriut dhe me besnikëri u jep formë ndjenjave të tij. Megjithatë, subkoshienca ka një neveri të veçantë për detyrimin dhe i përgjigjet më shumë bindjes sesa urdhërimit; dhe si rrjedhojë, ajo i ngjan më shumë gruas së dashur sesa shërbëtorit.

"Burri është kreu i gruas" -**Efesianët 5:23**, mund të mos jetë e vërtetë për burrin dhe gruan në marrëdhëniet e tyre tokësore, por është e vërtetë për koshiencën dhe subkoshiencën, ose për aspektet mashkullore dhe femërore të vetëdijes.

Misteri të cilit Pali iu referua kur ai shkroi, "Ky është një mister madhështor... **5:32** ... Ai që e do gruan e tij do veten e tij... **5:28** ... Dhe ata të dy do të jenë një mish i vetëm... **5:31**", është thjesht misteri i vetëdijes. Vetëdija është me

të vërtetë një dhe e pandarë, por për hir të krijimit ajo duket se është e ndarë në dy.

Aspekti i koshienës (objektive) ose mashkullore është me të vërtetë koka dhe dominon aspektin subkoshient (subjektiv) ose atë femërore. Megjithatë, kjo udhëheqje nuk është ajo e tiranit, por ajo e të dashurit.

Pra, duke pohuar ndjenjën që do të ishte e jotja në rast se ti e kishe tashmë objektivin tënd, subkoshienca shtyhet të ndërtojë ngjashmërinë e saktë të pohimit tënd.

Dëshirat e tua nuk pranohen në subkoshiençë derisa ti të marrësh ndjenjën e realitetit të tyre, sepse vetëm përmes ndjenjës pranohet një ide në mënyrë të pavetëdijshme dhe vetëm përmes këtij pranimi subkoshienca shprehet.

Është më e lehtë t'i atribuosh ndjenjën tënde ngjarjeve në botë sesa të pranosh se kushtet e botës pasqyrojnë ndjenjën tënde. Megjithatë, është përjetësisht e vërtetë se e jashtëmja pasqyron të brëndshmen.

"Si brënda, ashtu dhe jashtë"

"Si lart, ashtu dhe poshtë; si poshtë, poashtu edhe lart;

si brënda, poashtu edhe jashtë; si jashtë, poashtu edhe brënda"

"Korrespondenca", e dytë nga Shtatë Parimet e Hermes Trismegistus.

"Njeriu nuk mund të marrë asgjë nëse nuk i është dhënë nga qielli"

-Gjoni 3:27

"Mbretëria e qiellit është brënda teje"

-Luka 17:21

Asgjë nuk vjen nga jashtë; të gjitha gjërat vijnë nga brënda - nga subkoshienca.

Është e pamundur që ti të shohësh diçka tjetër përveçse përmbajtjes së vetëdijes tënde. Bota jote në çdo detaj është koshienca jote e objektivizuar. Gjendjet objektive dëshmojnë për përshtypjet subkoshiente. Një ndryshim i përshtypjes rezulton në një ndryshim të shprehjes.

Subkoshienca e pranon si të vërtetë atë që ti e ndjen të jetë e vërtetë, dhe për shkak se krijimi është rezultat i përshtypjeve subkoshiente, ti, me ndjenjën tënde, përcakton krijimin.

Ti je tashmë ajo që dëshiron të jesh dhe refuzimi yt për të besuar këtë është arsyeja e vetme që ti nuk e sheh atë. Të kërkosh nga jashtë atë që ti nuk e ndjen se je, është të kërkosh më kot, sepse ne kurrë nuk gjejmë atë që duam; ne gjejmë vetëm atë që ne jemi.

Me pak fjalë, ti shpreh dhe ke vetëm atë që ti je në vetëdijshmëri, se ti je ose zotëron.

“Atij që ka i jepet”

-Mateu 13:12; 25:29; Marku 4:25; Lluca 8:18; 19:26]

Mohimi i dëshmisë së shqisave dhe përvetësimi i ndjenjës së dëshirës së përmbushur është rruga drejt realizimit të dëshirës tënde. Zotërimi i vetëkontrollit të mendimeve dhe ndjenjave të tua është arritja jote më e lartë.

Megjithatë, derisa vetëkontrolli i përsosur të arrihet, në mënyrë që, pavarësisht nga pamja, ti të ndiesh gjithçka që ti dëshiron të ndiesh, përdor gjumin dhe lutjen për të të ndihmuar në realizimin e gjëndjeve të tua të dëshiruara.

Këto janë dy portat për në subkoshiençë.

Kapitulli 2

Gjumi

GJUMI, jeta që zë një të tretën e qëndrimit tonë në tokë, është dera e natyrshme në subkoshiençë.

Pra, është me gjumin që ne jemi të shqetësuar tani. Dy të tretat e vetëdijshe të jetës sonë në tokë maten me shkallën e vëmëndjes që ne i kushtojmë gjumit. Të kuptuarit dhe kënaqësia jonë për atë që gjumi duhet të na japë ne do të na bëjë që, natë pas nate, të nisemi drejt tij sikur ne të kishim një takim me një të dashur.

“Në një ëndërr, në një vegim nate, kur një gjumë i thellë mbi njerëzit bie, në gjumë mbi shtrat; ajo hap veshët e njerëzve dhe vulos mësimet e tyre”
-Jobi 33

Është në gjumë, dhe në lutje (një gjëndje e ngjashme me gjumin), që njeriu hyn në subkoshiençë për të lënë përshtypjet e veta dhe për të marrë udhëzimet e tij. Në këto gjëndje koshienca dhe subkoshienca bashkohen në mënyrë krijuese. Mashkulli dhe femra bëhen një mish i vetëm.

Gjumi është koha kur mendja mashkullore ose ajo e vetëdijshe kthehet nga bota e shqisave për të kërkuar të dashurën ose veten e saj, subkoshiençën.

Subkoshienca – ndryshe nga gruaja e botës që martohet me burrin e saj për ta ndryshuar atë – nuk ka dëshirë të ndryshojë gjëndjen e vetëdijshe, të zgjuar, por e do atë ashtu siç është dhe e riprodhon me besnikëri ngjashmërinë e tij në botën e jashtme të formës.

Kushtet dhe ngjarjet e jetës tënde janë fëmijët e tu të formuar nga kallëpet e përshtypjeve të tua subkoshiente në gjumë. Ato janë bërë në imazhin dhe ngjashmërinë e ndjenjës tënde më të brëndshme që mund t'i zbulohet vetes.

“Si në qiell, poashtu edhe në tokë”
-Mateu 6:10; Luka 11:2

Si në subkoshiençë, poashtu edhe në tokë.

Çfarëdo që ti ke në vetëdije ndërsa shkon për të fjetur, ajo është masa e shprehjes tënde në dy të tretat e zgjuara të jetës tënde në tokë.

Asgjë nuk të ndalon ty të realizosh objektivin tënd, përveç dështimit tënd për të ndjerë se ti je tashmë ajo që dëshiron të jesh, ose se ti tashmë je në zotërim të sendit të kërkuar. Subkoshienca jote u jep formë dëshirave të tua vetëm kur ti e ndjen se dëshira jote është përmbushur.

Pavetëdijshmëria e gjumit është gjëndja normale e subkoshiencës.

Për shkak se të gjitha gjërat vijnë nga brënda teje, dhe konceptimi yt për veten përcakton atë që vjen më pas, ti duhet që gjithmonë të ndjesh dëshirën e përmbushur përpara se të shkosh për të fjetur.

Ti asnjëherë nuk nxjerr nga thellësia e vetes atë që ti dëshiron; ti gjithmonë vizaton atë që ti je, dhe ti je ajo që ti ndjen se je, si dhe ajo që ti ndihesh si e vërtetë për të tjerët.

Për t'u realizuar, pra, dëshira duhet të zgjidhet në ndjenjën e të qenit ose të pasurit ose dëshmitarit të gjëndjes së kërkuar. Kjo realizohet duke supozuar ndjenjën e përmbushjes së dëshirës. Ndjenja që vjen si përgjigje ndaj pyetjes "Si do të ndihesha unë po të realizohej dëshira ime?" është ndjenja që duhet të monopolizojë dhe të mos levizë vëmëndjen tënde ndërsa ti pushon në gjumë. Tu duhet të jesh në vetëdijen se ti je ose ke tashmë atë që ti dëshiron të jesh ose të kesh përpara se të biesh për të fjetur.

Sapo fle, njeriu nuk e ka më lirinë e zgjedhjes. I gjithë gjumi i tij dominohet nga koncepti i tij i fundit i zgjuar për veten.

Prandaj, rrjedh se ai duhet të marrë gjithmonë ndjenjën e arritjes dhe kënaqësisë përpara ai se të tërhiqet në gjumë,

"Eja përpara meje me këngë dhe falënderime"
-Psalmi 95:2

"Hyr në portat e saj me falënderime dhe në oborret e saj me lavdërime"
-Psalmi 100:4

Humori yt përpara gjumit përcakton gjëndjen tënde të vetëdijes kur ti hyn në praninë e së dashurës tënde të përjetshme, subkoshiencës.

Ajo të sheh ty pikërisht ashtu siç ti e ndjen veten se je. Nëse, ndërsa ti përgatitesh për gjumë, poho dhe ruaj vetëdijen e suksesit duke ndjerë "Unë jam i suksesshëm", ti duhet të ndjesh se je i suksesshëm tashmë. Shtrihu në shpinë me kokën në një nivel me trupin tënd. Ndjehu ashtu siç ti do të ishe ndier nëse tashmë do ta kishe dëshirën tënde, dhe relaksohu në heshtje në pavetëdijshtëri.

"Ai që ruan Izraelin nuk do të dremisë dhe nuk do të flejë"

-Psalmi 121:4

Megjithatë;

"Ai ia jep dashurisë së të tij gjumin"

-Psalmi 127:2

Subkoshienca nuk fle kurrë. Gjumi është dera përmes së cilës kalon mëndja e vetëdijshtëme, e zgjuar për t'u bashkuar në mënyrë krijuese me subkoshiençën.

Gjumi fsheh aktin krijues, ndërsa bota objektive e zbulon atë. Në gjumë, njeriu i bën përshtypje subkoshiençës me konceptimin e tij rreth vetes së tij. Çfarë përshkrimi më të bukur për këtë romancë të koshiençës dhe subkoshiençës ka se sa ajo që thuhet te "Kënga e Solomonit":

"Natën në shtratin tim kërkova atë që do shpirti im [3:1]... E gjeta atë që shpirti im do;

E mbajta dhe nuk e lashë të shkojë, derisa e solla në shtëpinë e nënës sime dhe në dhomën e saj që më ngjiz." [3:4]

Duke u përgatitur për të fjetur, ti e ndjen veten në gjëndjen e dëshirës së përgjigjur dhe më pas relaksohesh në pavetëdijshtëri. Dëshira jote e realizuar është ajo që kërkon.

Natën, në shtratin tënd, kërkoi ndjenjën e dëshirës së përmbushur që ta marrësh atë me vete në dhomën e saj që të ka ngjizur, në gjumë ose në subkoshiençën që të ka dhënë formë, që edhe kësaj dëshire ajo ti shprehet.

Kjo është mënyra për të zbuluar dhe përcjellë dëshirat e tua në subkoshiencë. Ndjeje veten në gjëndjen e dëshirës së realizuar dhe bjer në heshtje për të fjetur.

Natë pas nate, ti duhet të pohosh ndjenjën e të qënurit, e të pasurit dhe të dëshmitarit të asaj që ti kërkon të jesh, zotërosh dhe shohësh të manifestuar. Asnjëherë mos shko për të fjetur duke u ndjerë i dekurajuar apo i pakënaqur. Asnjëherë mos fli në vetëdijen e dështimit.

Subkoshienca jote, gjëndja natyrore e cila është gjumi, të sheh ty ashtu siç ti e beson veten të jesh dhe pavarësisht nëse është e mirë, e keqe apo indiferente, subkoshienca do të mishërojë besnikërisht besimin tënd.

Ashtu siç ti ndihesh, ti i bën përshtypje asaj; dhe ajo, e dashura perfekte, u jep formë këtyre përshtypjeve dhe i paraqet ato si fëmijët e të dashurit të saj.

Kënga e Solomonit 4:7; “Ti je e gjitha e drejtë, dashuria ime; nuk ka asnjë njollë në ty” është qëndrimi i mendjes që ti duhet të përvetësosh përpara se ti të biesh për të fjetur.

Shpërfille pamjen dhe mendo se gjërat janë ashtu siç ti dëshiron të jenë, sepse ...

“Ai i quan gjërat që nuk janë sikur ato të ishin, dhe e padukshmja bëhet e dukshme”

-Romakët 4:17

Të supozosh ndjenjën e kënaqësisë do të thotë të thërrasësh në ekzistencë kushte të cilat do të pasqyrojnë kënaqësinë.

“Shënjat pasojnë, ato nuk paraprijnë”

Dëshmia që ti je do të ndjekë vetëdijen që ti je; ajo nuk do t'i paraprijë.

Ti je një ëndërrimtar i përjetshëm që ëndërron ëndrra jo të përjetshme. Ëndrrat e tua marrin formë ndërsa ti supozon ndjenjën e realitetit të tyre.

Mos e kufizo veten në të kaluarën.

Duke ditur se asgjë nuk është e pamundur për vetëdijen, fillo të imagjinosh gjëndje përtej përvojave të së kaluarës.

Çfarëdo që mëndja e njeriut mund të imagjinojë, njeriu mund ta realizojë. Të gjitha gjëndjet objektive (të dukshme) kanë qënë së pari gjëndje subjektive (të padukshme), dhe ti i ke quajtur ato të dukshme duke supozuar ndjenjën e realitetit të tyre.

Procesi krijues është fillimisht të imagjinosh dhe më pas të besosh gjëndjen e imagjinuar. Gjithmonë imagjino dhe prit më të mirën. Bota nuk mund të ndryshojë derisa ti të ndryshosh konceptin tënd rreth saj.

"Si brënda, poashtu edhe jashtë"

Kombet, poashtu dhe njerëzit, janë vetëm ato që ti beson se ato janë. Sido që të jetë problemi, kudo që të jetë, kujtdo qoftë ai, ti nuk ke kë të ndryshosh përveçse veten dhe ti nuk ke as kundërshtar e as ndihmës për të sjellë ndryshimin brënda vetes. Ti nuk ke asgjë për të bërë veçse të bindesh për të vërtetën e asaj që ti dëshiron të shohësh të manifestuar.

Sapo të arrish të bindësh veten për realitetin e gjëndjes së kërkuar, pasojnë rezultatet për të konfirmuar besimin tuaj fiks. Ti asnjëherë nuk duhet të sugjerosh tjetrit gjëndjen që ti dëshiron ta shohësh atë që ai të shprehë; në vënd të kësaj, ti e bind veten se ai tashmë është ai që ti dëshiron të jetë.

Realizimi i dëshirës tënde realizohet duke supozuar ndjenjën e përmbushjes së dëshirës. Ti nuk mund të dështosh nëse nuk arrin ta bindësh veten për realitetin e dëshirës tënde. Ndryshimi i besimit konfirmohet nga një ndryshim i shprehjes.

Çdo natë, ndërsa bie për të fjetur, ndjehu i kënaqur dhe i panjollë, sepse e dashura jote subjektive gjithmonë formon botën objektive në imazhin dhe ngjashmërinë e konceptimit tënd rreth saj, konceptimin e përcaktuar nga ndjenja jote.

Zgjimi i dy të tretave të jetës tënde në tokë vërteton ose dëshmon për përshtypjet e tua subkoshiente. Veprimet dhe ngjarjet e ditës janë efekte; nuk janë shkaktarë. Vullneti i lirë është vetëm liria e zgjedhjes.

Joshua 24:15 "Zgjidh sot se kujt do t'i shërbesh" është liria jote për të zgjedhur llojin e gjëndjes shpirtërore që ti merr; por shprehja e gjëndjes shpirtërore është sekreti i subkoshientës. Subkoshienca i merr përshtypjet vetëm përmes ndjenjave të njeriut dhe, në një mënyrë të njohur vetëm për veten, ajo u jep këtyre përshtypjeve formë dhe shprehje.

Veprimet e njeriut përcaktohen nga përshtypjet e tij subkoshiente.

Iluzioni i tij i vullnetit të lirë, besimi i tij në lirinë e veprimit, nuk është veçse injoranca e shkaqeve që e bëjnë atë të veprojë. Ai e mendon veten të lirë sepse ai ka harruar lidhjen mes vetes dhe ngjarjes. Njeriu i zgjuar është i detyruar t'ia shprehi përshtypjet e tij subkoshiencës. Nëse në të kaluarën ai i bëri përshtypje vetes në mënyrë të pamatur, atëherë lëre atë të fillojë të ndryshojë mendimin dhe ndjenjën e tij, sepse vetëm duke e bërë këtë ai do të ndryshojë botën e tij. Mos humb asnjë moment në keqardhje, sepse të mendosh me ndjenja për gabimet e së kaluarës do të thotë të riinfektosh veten.

“Lëri të vdekurit të varrosin të vdekurit”

-Mateu 8:22; Lluka 9:60

Hiq dorë nga pamja e jashtme dhe poho ndjenjën që do të ishte e jotja nëse do të ishte tashmë ajo që ti dëshiron të jesh. Ndjenja e një gjëndjeje e prodhon atë gjëndje. Pjesa që ti luan në skenën botërore përcaktohet nga konceptimi yt rreth vetes.

Duke ndier përmbushjen e dëshirës tënde dhe duke pushuar në heshtje në gjumë, ti e vendos veten në një rol ylli që do të luhet nesër në tokë dhe, ndërsa je në gjumë, ti përsëritesh dhe udhëzohesh në pjesën tënde.

Pranimi i qëllimit automatikisht do mjetet e realizimit. Mos bëj asnjë gabim për këtë. Nëse, ndërsa përgatitesh për gjumë, ti nuk e ndjen veten me vetëdije në gjëndjen e dëshirës tashmë të përgjigjur, atëherë ti do të marrësh me vete në dhomën e asaj që të konceptoi shumën totale të reagimeve dhe ndjenjave të ditës së zgjuar; dhe ndërsa je në gjumë, do të udhëzohesh në mënyrën se si ato do të shprehen nesër.

Ti do të ngrihesh duke besuar se je një agjent i lirë, duke mos kuptuar se çdo veprim dhe ngjarje e ditës është e paracaktuar nga koncepti yt rreth vetes ndërkohë që ti ishe në gjumë.

Liria jote e vetme, pra, është liria jote e reagimit. Ti je e lirë të zgjedhësh se si ti ndihesh dhe si reagon ndaj dramës së ditës, por drama – veprimet, ngjarjet dhe rrethanat e ditës – janë përcaktuar tashmë.

Nëse nuk përcakton me vetëdije dhe qëllim qëndrimin e mëndjes me të cilën ti shkon për të fjetur, ti, në mënyrë të pavetëdijshme shkon për të fjetur në qëndrimin e përbërë të mëndjes së përbërë nga të gjitha ndjenjat dhe

reagimet e ditës. Çdo reagim bën një përshtypje subkoshiente dhe, nëse ajo nuk kundërshtohet nga një ndjenjë e kundërt dhe më dominuese, ajo është shkak i veprimit të ardhshëm.

Idetë e mbështjella me ndjenja janë veprime krijuese. Përdor të drejtën tënde hyjnore me mënçuri. Nëpërmjet aftësisë tënde për të menduar dhe ndjerë, ti ke dominim mbi të gjithë krijimin.

Ndërsa je zgjuar, ji një kopshtar që zgjedh farën për kopshtin tënd, por “Nëse një kokërr gruri nuk bie në tokë dhe nuk vdes, ajo mbetet e vetme; por nëse vdes, ajo jep shumë fryt.” -Gjoni 12:24

Konceptimi yt për veten ndërsa ti bie në gjumë është fara që ti hedh në tokën e subkoshiencës. Të biesh në gjumë duke u ndjerë e kënaqur dhe e lumtur detyron që në botën tënde të shfaqen kushte dhe ngjarje që konfirmojnë këto qëndrime mendore.

Gjumi është dera për në parajsë. Atë që ti e merr si ndjenjë, ti e nxjerr si gjëndje, veprim ose objekt në hapësirë. Pra fli në ndjenjën e dëshirës së përmbushur.

Kapitulli 3

Lutja

LUTJA, si gjumi, është gjithashtu një hyrje në subkoshiençë.

“Kur të lutesh, hyr në dollapin tënd dhe kur të mbyllësh derën, lutju Atit tënd që është në fshehtësi dhe Ati yt që është në fshehtësi do të të shpërblejë haptas”

-Mateu 6:6

Lutja është një iluzion i gjumit që pakëson përshtypjen e botës së jashtme dhe e bën mëndjen më pranuese ndaj sugjerimeve të brëndshme. Mëndja në lutje është në një gjëndje relaksi dhe pranueshmërie të ngjashme me ndjenjën e arritur pak para se ti të biesh për të fjetur.

Lutja nuk është aq shumë ajo që ti kërkon, sesa mënyra se si ti përgatitesh për pranimin e saj.

“Çdo gjë që ti dëshiron, kur lutesh, beso se e ke marrë atë dhe do t'a kesh”

-Marku 11:24

Kushti i vetëm që kërkohet është që ti të besosh se lutjet e tua tashmë janë realizuar. Lutja jote duhet të përgjigjet nëse ti pohon ndjenjën që do të ishte e jotja po ta kishe tashmë objektivin tënd. Në momentin që ti e pranon dëshirën si fakt të kryer, subkoshienca gjen mjete për realizimin e saj. Për t'u lutur me sukses atëherë, ti duhet t'i dorëzohesh dëshirës, domethënë të ndjesh dëshirën e përmbushur.

Njeriu i disiplinuar në mënyrë të përkryer është gjithmonë në harmoni me dëshirën si një fakt i kryer. Ai e di se vetëdija është realiteti i vetëm, se idetë dhe ndjenjat janë fakte të vetëdijes dhe janë po aq reale sa objektet në hapësirë; prandaj ai kurrë nuk ka një ndjenjë që nuk kontribuon në lumturinë e tij, sepse ndjenjat janë shkaqet e veprimeve dhe rrethanave të jetës së tij.

Nga ana tjetër, njeriu i padisiplinuar e ka të vështirë të besojë atë që mohohet nga shqisat dhe zakonisht pranon ose refuzon vetëm në pamjen e shqisave.

Për shkak të kësaj tendence për t'u mbështetur në dëshminë e shqisave, është e nevojshme t'i mbyllësh ato përpara se të fillosh të lutesh, përpara se të përpiqesh të ndjesh atë që ato mohojnë. Sa herë që ti je në gjëndjen shpirtërore "Unë dua, por nuk mundem", sa më shumë që të përpiqesh, aq më pak ti je në gjëndje t'i dorëzohesh dëshirës.

Ti kurrë nuk tërheq atë që ti dëshiron, por tërheq gjithmonë atë që ti je në vetëdijshmëri se ti je. Lutja është arti i supozimit të ndjenjës së të qënurit dhe të pasurit atë që ti dëshiron. Kur shqisat konfirmojnë mungesën e dëshirës tënde, të gjitha përpjekjet e vetëdijshme për të kundërshtuar këtë sugjerim janë të kota dhe tentojnë të intensifikojnë sugjerimin.

Lutja është arti i dorëzimit ndaj dëshirës dhe jo detyrimi i dëshirës. Sa herë që ndjenja jote është në konflikt me dëshirën tënde, ndjenja do të jetë fitimtare. Ndjenja mbizotëruese shprehet pa ndryshim. Lutja duhet të jetë pa përpjekje. Në përpjekjen për të rregulluar një qëndrim të mendjes që mohohet nga shqisat, përpjekja është fatale.

Për t'iu nënshtruar me sukses dëshirës si një fakt i arritur, ti duhet të krijosh një gjëndje pasive, një lloj përfytyrimi ose reflektimi meditues të ngjashëm me ndjenjën që i paraprin gjumit. Në një gjëndje kaq të relaksuar, mendja largohet nga bota objektive dhe ndjen lehtësisht realitetin e një gjëndje subjektive. Ajo është një gjëndje në të cilën ti je në vetëdijshmëri dhe mjaft e aftë të lëvizësh ose hapësh sytë, por që nuk ke dëshirë ta bësh këtë.

Një mënyrë e thjeshtë për të krijuar këtë gjëndje pasive është të relaksohesh në një karrige të rehatshme ose në një shtrat. Nëse je në shtrat, shtrihu me shpinë me kokën në një nivel me trupin, mbyll sytë dhe imagjino se je e përgjumur.

Ndieje atë - Unë jam e përgjumur, shumë e përgjumur, kaq shumë e përgjumur. Pas pak, një ndjenjë e largët e shoqëruar me një plogështi të përgjithshme dhe humbje të çdo dëshire për të lëvizur të mbështjell ty. Ti ndjen një pushim të këndshëm, të rehatshëm dhe nuk je në prirje për të ndryshuar pozicionin tënd, megjithëse në rrethana të tjera nuk do të ishit aspak rehat.

Kur gjëndje pasive të arrihet, imagjino se e ke realizuar dëshirën tënde - jo si u realizua, por thjesht dëshira e përmbushur. Imagjino në formë fotografie atë që ti dëshiron të arrish në jetë; atëherë ndjeh veten sikur tashmë e ke arritur atë.

Mendimet prodhojnë lëvizje të vogla të të folurit, të cilat mund të dëgjohen në gjëndjen pasive të lutjes si thënie nga jashtë. Megjithatë, kjo shkallë pasiviteti nuk është thelbësore për realizimin e lutjeve të tua. Gjithçka që është e nevojshme është që të krijosh një gjëndje pasive dhe të ndjesh përmbushjen e dëshirës.

Gjithçka që ti mund të kesh nevojë për ose dëshirosh është tashmë e jotja. Ti nuk ke nevojë për ndihmës që të ta japë atë; ajo është e jotja tashmë. Thirr dëshirat e tua në ekzistencë duke imagjinuar dhe ndjerë përmbushjen e dëshirës tënde.

Ndërsa qëllimi pranohet, ti bëhesh krejtësisht indiferent ndaj dështimit të mundshëm, sepse pranimi i qëllimit do mjetet për këtë qëllim. Kur del nga momenti i lutjes, është sikur të tregohet fundi i lumtur dhe i suksesshëm i një shfaqjeje, megjithëse nuk t'u tregua se si ai përfundim u arrit.

Megjithatë, duke qënë dëshmues i fundit, pavarësisht nga çdo sekuencë antiklimatike, ti qëndron në qetësi dhe siguri duke ditur se fundi është përcaktuar në mënyrë të përsosur tashmë.

Kapitulli 3

Ndjenja

“Jo me forcë, as me pushtet, por me frymën time, thotë Zoti i ushtrive”

-Zakaria 4:6

Hyni në frymën e gjendjes së dëshiruar duke supozuar ndjenjën që do të ishte e juaja po të ishit tashmë ai që dëshironi të jeni. Ndërsa kapni ndjenjën e shtetit të kërkuar, ju liroheni nga çdo përpjekje për ta bërë atë të tillë, sepse tashmë është kështu. Ekziston një ndjenjë e caktuar që lidhet me çdo ide në mendjen e njeriut. Kapni ndjenjën që lidhet me dëshirën tuaj të realizuar duke supozuar ndjenjën që do të ishte e juaja nëse tashmë do të zotëroni atë që dëshironi dhe dëshira juaj do të objektivizohet.

Besimi është ndjenja,

“Sipas besimit tënd (ndjenjës), qoftë ajo në ty.” -Mateu 9:29

Ti asnjëherë nuk tërhiq atë që ti dëshiron, por gjithmonë atë që ti je. Ashtu siç njeriu është, ashtu dhe ai sheh.

“Atij që ka do t’i jepet dhe atij që nuk ka do t’i merret...”

-Mateu 13:12; 25:29; Marku 4:25; Lluca 8:18; 19:26

Ajo që ti e ndjen veten të jesh, ti je, dhe ty të jepet ajo që ti je. Pra, supozo ndjenjën që do të ishte e jotja po ta kishe tashmë dëshirën tënde, dhe dëshira jote duhet të realizohet.

“Kështu Zoti e krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së tij, sipas shëmbëlltyrës së Zotit ai e krijoi atë” -Zanafilla 1:27

“Le të jetë në ty kjo mendje që ishte edhe në Krishtin Jezus, i cili, duke qënë në trajtën e Zotit, mendoi se nuk ishte grabitje të jesh i barabartë me Zotin”

-Filipianët 2:5,6

Ti je ajo që ti beson se je. Në vënd që të besosh në Zot ose Jezus – beso se ti je Zot ose Krisht.

“Ai që beson në mua, në veprat që unë bëj, do t’i bëjë edhe ai” **Gjoni 14:12** - duhet të jetë - “Ai që beson, siç unë besoj në veprat që unë bëj, do të bëjë edhe ai”.

Jezusi nuk e kishte të zorshme të bënte veprat e Zotit, sepse ai besonte se ai ishte vetë Zot.

“Unë dhe Ati im jemi Një” -Gjoni 10:30

Eshtë e natyrshme të bësh punët e atij që ti beson se je. Pra, jeto në ndjenjën e të qënies ajo që ti dëshiron dhe do që të jesh. Kur një njeri beson në vlerën e këshillave që atij i janë dhënë dhe ai i zbaton ato, ai vendos në brëndësi të vetes realitetin e suksesit të tij.

Ky botim elektronik u publikua në Shqip në vitin 2023 nga Ionweb

Përktheu **Ledion Azemaj**

ionweb

tia



Ndjenja
eshte
Sekreti

Perktheu Ledion Azemaj

NEVILLE